

VENDIM
Nr.1649, datë 24.12.2008

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE
NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË
KRYERA NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE,
BASHKI, KOMUNA E KËSHILLI I QARKUT TË DIBRËS, SI AUTORITETE
KONTRAKTUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-kanalizimeve, të bashkive, komunave dhe këshillit të qarkut të Dibrës të shtyjnë afatin e botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, deri më 31 dhjetor 2008, për procedurat e prokurimit të fondeve buxhetore të investimeve, për 16 objekte, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-kanalizimeve, Agjencia e Prokurimit Publik, bashkitë, komunat dhe këshilli i qarkut të Dibrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT
Drejtoria e Përgjithshme Ujësjetllës-kanalizimeve

Nr.	Emërtimi i projektit	Komuna/bashkia	Vlera e plotë e projektit
	Granti konkurrues, Objekte të reja		
1	Ndërtim KUB fshati Hamallaj, bashkia Manëz	bashkia Manëz	34,250
2	Rikonstruksion Ujësjiellësi Çlirim, komuna qendër Fier	komuna Qendër	24,344
3	Rikonstruksion i ujësjiellësit të fshatit Petrelë, komuna Petrelë	komuna Petrelë	36,255
4	Kuz Lundër, komuna Farkë	komuna Farkë	39,230
5	Kuz dhe KUB të rrugës “Rruga nacionale-Mjull Bathore”, Komuna Farkë	komuna Farkë	16,479
6	Ujësjiellësi rajonal Aliko, komuna Aliko, Sarandë	komuna Aliko	98,140
7	Ujësjiellësi i fshatit Korre, komuna Funar, Elbasan	komuna Funar	9,587
8	Ndërtim ujësjiellësi Sopanike (varianti me vetërrjedhje), objekt në vazhdim	këshilli i qarkut Dibër	24,317
9	Ujësjiellësi i fshatit Arzë, komuna Miras, Korçë	komuna Miras	18,000
10	Përfundimi i ujësjiellësit Patin, bashkia Klos	bashkia Klos	16,816
11	Rikonstruksion ujësjiellësi i fshatit Hotoloshit-Qendër, komuna Hotoloshit, Librazhd	komuna Hotoloshit	4,989
12	Linja e re e ujësjiellësit Piskovë, komuna Piskovë, Gjirokastrë	komuna Piskovë	3,174
13	KUZ zona a banimit “Ura e Beshirit”, komuna Ndroq, Tiranë	komuna Ndroq	55,700
14	KUZ të fshatrave Marqinet-Gërdec, bashkia Vorë	bashkia Vorë	92,065
15	Rikonstruksion i ujësjiellësit të fshatrave Gërdec, Marqinet 2 dhe Marqinet 1, bashkia Vorë	bashkia Vorë	89,901
16	Rrjeti i ri i KUZ të fshatit Mbrostar-Ura (faza e parë), komuna Mbrostar, Fier	komuna Mbrostar	56,764